



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALBANA XH. SPAHIU
ADRESA NR.9, HAXHI HYSEN
DALLIU, NR.59, NR.11
TEL: 672530602

PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.P.K.-VE

(AKT THEMELIMI DHE STATUT)

Nr. repertori: 1658

Nr. koleksioni: 585

Tirane më 19/05/2023



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2023051000062835763



A2023051000062835763



AKT THEMELIMI dhe STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA

“G&M ALBANIA” Shpk

Sot me datë 19 MAJ 2023, para meje Notere ALBANA XH. SPAHIU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.9, HAXHI HYSEN DALLIU, NR.59, NR.11, u u paraqit personalisht:

Z. **STEFANO GENTILE**, atësia Roberto, amësia Elisabetta, shtetas Italian, lindur në DOLO (VE) dhe banues në Dolo, me adresë Via Roma, N. 80, Noventa Padovana (PD), Itali, lindur më 04/03/1988, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjostim ID nr. CA21546KS dhe nr. personal CA21546KS

Personi i paraqitur flet dhe komunikon me noteren ne gjuhen Angleze, dhe deklaron se ka zgjedhur të asistohet në përkthim verbal nga Shqip në Anglisht, nga Noterja, përkthyese e zyrtare per gjuhes angleze, e licensuar nga Ministria e Drejtësisë.

I cili me cilësine e “Ortakut te vetëm Themelues”, kërkoi perpilimin e Akt Themelimi & Statut, nëpërmjet të cilit deklaronë se, me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë dhe inisiativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqiperise dhe Kodin Civil në fuqi, Ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqërите tregtare" i ndryshuar, Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ", Ligjin nr. 10428 date 10.06.2011 "Për të Drejtë Nderkombetare Private", ne legjislacionin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon nëpërmjet këtij Akti, shoqerinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“G&M ALBANIA” shpk**, Tiranë, si më poshtë:

I.
AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË “G&M ALBANIA” Shpk

KAPITULLI 1

Neni 1
Themelimi

Shoqëria **“G&M ALBANIA” Shpk** është person juridik i të drejtës juridike shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (këtu në vijim do të referohet si “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti Juridik

Shoqëria përfiton personalitetin juridik pas regjistrimit në Qendren e Regjistrimit të Kompanive sipas kërkesave dhe procedurave që parashikon Ligji.

Shoqëria, pasi përfiton personalitetin juridik, është përgjegjëse kundrejt palëve të treta për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj.



A2023051000062835763

Shoqëria "G&M ALBANIA" Shpk është një shoqëri, e themeluar midis ortakëve që u përgjigjen humbjeve deri në limitin e vlerës së kontribuar në kapitalin e shoqërisë.

Neni 3

Selia

Shoqëria ka selinë në Tiranë Njesia Bashkiake nr 5 Blvd Deshmoret e Kombit, Twin Towers Kulla2 Kati3 1031 Tirane.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, mund të hapë zyra përfaqësie, filiale, mund të krijojë degë si brënda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me Vendim të Asambleës së Përgjithshme.

Neni 5

Objekti i aktivitetit

Objekti i veprimtarise se shoqerise:

tropmi"-Eksport, tregtim me shumice e pakice i te gjitha llojeve te mallrave industrial, ushqimore, bujqesore, pellet.

Prodhimi dhe tregtimi i materialeve te ndertimit.

Organizimi dhe realizimi i panaireve dhe ekspozitave për muzetë dhe çdo promovim eventual i nevojshem per importet-eksportet e produkteve tipike dhe lëndëve të para të çdo vendi të interesuar në projektet e tregtise dhe shqembimit te mallrave me vendet e tjera.

Prodhim dhe tregtim, artikuj te ndryshem industriale dhe ushqimore.

Import-Export dhe tregtim, artikuj te ndryshem konfensionesh, kerpi, lini, etj. te perfimduara dhe gjysem te perfunduara.

Import-Export dhe tregtim, artikuj te fushes se kozmetikes & te estetikes;

Import-Export dhe tregtim, materiale plastike te llojeve dhe formave te ndryshme;

Blerje dhe tregtim, automjete Avioneve dhe anijeve te markave dhe tonazheve te ndryshme, te personalizuar per transportin e njerezve dhe mallrave per linja kombetare dhe nderkombetare."

Neni 5

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë "G&M ALBANIA" Shpk është fiksuar deri më 31 Dhjetor 2050.

**KAPITULLI 2
KAPITALI**

Neni 6

Kapitali themeltar

-Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njeqind) leke

-**Z. Stefano Gentile**, i lindur në Dolo (VE) më 04/03/1988 banues në Itali, madhor me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, identifikuar me Leternjoftim Italian Nr.CA21546KS zoteron 1 (një) kuotë e barabarte me 100% te kapitalit te shoqerise e barabarte me vleren 100 Lekë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga vlera të tregtueshme.

Kontributi i ortakut mund të derdhet në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/pasuri të paluajtshme ose të drejta).

Ortaket që cënohen të ushtrojnë të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i pjesës në shoqëri, kane të drejtë të kërkojnë nga gjykata urdhër ndalimin e shkeljes ose shpërblimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë ushtrohet brenda 3 viteve nga momenti i shkeljes.



Neni 7

Mënyra e transferimit të kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej saj mund të blihen ose transferohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë,
- shitjes,
- trashëgimisë,
- dhurimit,
- çdo mënyre tjetër të parashikuar nga ligji.

Në rastin e kalimit të aksioneve me kontratë, kjo kontratë duhet të bëhet me shkrim.

Statuti mund ta kushtëzojë transferimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin ose të drejtën e parablerjes së shoqërisë në favor të shoqërisë ose ortakëve të tjerë.

Në rastin e transferimit të kuotave me kontratë, afatet dhe kushtet e transferimit të titullit të kuotës, si dhe kushtet e tjera kalimtare, duke përfshirë pagesën për blerjen e kuotave, rregullohen nga kontrata. Kontrata për transferimin e kuotave hartohet me shkrim dhe noterizimi nuk është kusht për vlefshmërinë ose regjistrimin e kontratës. Me përashtim të rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj ose kur palët bien dakord për një kontratë, vlefshmëria, e së cilës, për kalimin e titullit të pronësisë mbi kuotat, nuk i nënshtronhet procedurave administrative të ndryshme me efekt deklarues, përfshirë këtu edhe procedurat e regjistrimit ose publikimit të kontratës ose transferimit të titullit.

KAPITULLI III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE MENAXHUESE

Neni 8

Organi i Vendimmarrjes

Asambleja e Ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës në Shoqëri.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton ndryshimet në statut sipas procedurave të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për vendimet e marra nga shoqëria për sa vijon:

- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet statutore;
- emërimi dhe shkarkimin e Administratorëve;
 - emërimi dhe shkarkimin e likujdatorëve dhe e ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - përcaktimi dhe shpërblimi i pësonave të cituar në gërmat "c" e "ç" të kësaj pike;
 - mbikëqyrja mbi zbatimin e politikave tregtare nga ana e Administratorëve, duke përfshirë përgatitjen e bilanceve vjetore dhe raportet mbi progresin e biznesit;
 - miratim të bilanceve vjetore dhe raporteve mbi progresin e biznesit;
 - rritje dhe zvogëlim të kapitalit;
 - ndarja e kuotave si dhe anullimi i tyre;
 - përfaqësimi i shoqërisë në gjykim dhe procedime të tjera kundrejt Administratorëve;
 - riorganizim dhe shpërbërje të shoqërisë;
 - miratimi i rregullave procedurale për mbledhjet e Asamblesë;
 - kërkojë kredi pranë çdo banke ose institucioni finanziar.
- Çështje të tjera të parashikuara në ligj ose në Statut.

Ortaket mund të përfaqësohen në Asamblenë e Përgjithshme, nga një ortak tjetër ose nga një palë e tretë me anë të një autorizimi.

Drejtori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për pjesëmarrje në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet e ardhshme që do të kenë të njëjtin rend dite.





Neni 9
Administrimi

Z. Stefano Gentilim shtetas italian, i lindur në Dolo (VE) me 04/03/1988 banues ne adrese Via Roma, n. 80, Noventa Padovana, (PD) Itali me dokument identifikimi Leternjoftim CA21546KS, me kod fiskal CF. GNTSFN88C04D325W është Administrator sipas Statutit dhe Ligjit për një periudhë kohore prej pese (5) vitesh me të drejtë rinovimi duke filluar nga data 19.05.2023 - 19.05.2028.

Asambleja e përgjithshme mund t'i shkarkojë administratorët në çdo kohë kur arrihet shumica.

Ne rast se emerohen me shume se një administratore, ata veprojne se bashku apo vec e vec.

Statuti ose marrëveshje të tjera nuk mund ta përjashtojnë ose kufizojnë këtë të drejtë.

Gjithashtu, Administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të njërit prej ortakëve.

Të drejtat e përfaqësimit të Administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre duhet të njoftohen për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person, jo ortak.

Neni 10
Kompetencat

Administratori autorizohet dhe ka detyrimin të:

- a) kryejë të gjitha operacionet e administrimit të aktivitetit tregtar, duke aplikuar politikat tregtare të caktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) ofrojë asistencë për mirëmbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
- ç) hartojë dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve dhe ia dorëzon këto dokumente Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) të krijojë një sistem paralajmërimi për rr Ethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e biznesit dhe ekzistencën e kompanisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme për shoqërinë, sipas ligjit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- e) raportojë së pari para Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe zbatimin e veprimeve specifike me rëndësi të veçantë për biznesin e shoqërisë tregtare.
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara nga ligji dhe Statuti.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e zakonshme të menaxhimit. Administratori përfaqëson shoqërinë përparrë të gjithë personave fizikë dhe juridikë, autoritetet publike dhe/ose private, vendase ose të huaja, shqiptare ose të huaja, përfshirë autoritetet gjyqësore të të gjitha niveleve, bankat e të gjitha niveleve, etj. Administratori ka kompetencë të veprojë në marrëdhënie me të tretët për llogari të shoqërisë, si dhe para bankave të të gjitha niveleve, të kryejë transferta, tērheqje etj., pranë zyrave të tatimeve, zyrave të administratës vendore, punës, doganave, autoritetet etj. në të gjitha rr Ethanat, me përjashtim të kompetencave që ligji u jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori e përfshin shoqërinë në marrëdhënie me të tretët nëpërmjet akteve në përputhje me objektin e tij të veprimtarisë.

Neni 11
Viti Fiskal

Viti finanziar i kompanisë fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Me përjashtim të vitit të



A2013051000062835763

parë finansiar i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor.

Neni 12

Baza Ligjore

Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për gjithçka që nuk parashikohet në këtë akt, zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të Kodit Civil dhe të çdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13

Mosmarrëveshjet

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit dhe interpretimit të këtij akti themelues, si dhe për mosmarrëveshjet e tjera që mund të lindin ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, kompetente do të jetë Gjykata Shqiptare.

Neni 14

Dispozitat përfundimtare

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 kopje me të njëjtën vlerë ligjore, në shqip "G&M ALBANIA" dhe italisht dhe është miratuar nga aksionerët e shoqërisë tregtare "G&M ALBANIA" Shpk dhe është nënshkruar në të gjitha kopjet duke shkruar emrin, mbiemrin, dhe firmën origjinale.

**ORTAKU THEMELUES
I SHOQËRISË
"G&M ALBANIA" Shpk**

STEFANO GENTILE
Stefano Gentile

NOTERË



Albenia Spelley



II.

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“G&M ALBANIA” Shpk

Sot, në Tiranë, më 19.05.2023 në përputhje me kriteret e Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, u hartua ky Statut i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara me ortak themelues:

Z. Stefano Gentili, shtetas italian, i lindur në Dolo (VE) me 04/03/1988 banues në adresë Via Roma, n. 80, Noventa Padovana, (PD) Itali me dokument identifikimi Leternjoftim CA21546KS, me kod fiskal CF. GNTSFN88C04D325W

KAPITULLI 1

Neni 1
Themelimi

Shoqëria “**G&M ALBANIA** Shpk” është person juridik i të drejtës juridike shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuari (këtu në vijim do të referohet si “Shoqëria”).

Neni 2

Shoqëria “**G&M ALBANIA** Shpk” është një shoqëri tregtare, e themeluar nga Ortakët, e cila nuk përgjigjet për borxhet e kontraktuara nga shoqëria dhe mbalon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e jashtëzakonshme të kontributive të nënshkruara.

Kontributi i Ortakut përfaqëson kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gëzojne pjesën e tyre në shoqëri, në raport me kontributet e paguara në kapitalin shoqëror.

Neni 3
Selia

Shoqëria ka selinë në Tiranë Njesia Bashkiake nr 5 Blvd Deshmoret e Kombit, Twin Towers Kulla2 Katë3 1031 Tirane.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, mund të hapë zyra përfaqësie, filiale, mund të krijojë degë si brënda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm më Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4
Objekt i aktivitetit

Objekti i veprimtarise se shoqerise:



Import-Eksport, tregtim me shumice e pakice i te gjitha llojeve te mallrave industrial, ushqimore, bujqesore, pellet.

Organizimi dhe realizimi i panaireve dhe ekspositave për muzetë dhe çdo promovim eventual i nevojshem per importet-eksportet e produkteve tipikë dhe lëndëve të para të çdo vendi të interesuar në projektet e tregtise dhe shqembimit te mallrave me vendet e tjera.

Prodhim dhe tregtim, artikuj te ndryshem industriale dhe ushqimore.

Import-Export dhe tregtim, artikuj te ndryshem konfensionesh, kerpi, lini, etj. te perfimduara dhe gjysem te perfunduara.

Import-Export dhe tregtim, artikuj te fushes se kozmetikes & te estetikes;

Import-Export dhe tregtim, materiale plastike te llojeve dhe formave te ndryshme;

Blerje dhe tregtim, automjete Avioneve dhe anijeve te markave dhe tonazheve te ndryshme, te personalizuar per transportin e njerezve dhe mallrave per linja kombetare dhe nderkombetare.

Neni 5
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë “G&M ALBANIA” Shpk është fiksuar deri më 31 Dhjetor 2050.

**KAPITULLI 2
KAPITALI**

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njeqind) leke

Z. Stefano Gentilim shtetas italian, i lindur në Dolo (VE) me 04/03/1988 banues ne adresë Via Roma, n. 80, Noventa Padovana, (PD) Itali me dokument identifikimi Leternjoftim CA21546KS, me kod fiskal CF. GNTSFN88C04D325W zoteron nje kuote e barabarte me 100% te kapitalit te shoqerise e barabarte me vleren 100 leke.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga vlera të tregtueshme.

Kontributi i ortakeve mund të derdhet në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/pasuri të paluajtshme ose të drejta).

Ortaket që cënohet të ushtrojë të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i pjesës në shoqëri, ka të drejtë të kërkojë nga gjykata urdhër ndalimin e shkeljes ose shpërblimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë ushtrohet brenda 3 viteve nga momenti i shkeljes.

Neni 7
Rritje dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të rritet me nënshkrimin e pjesëve të kapitalit në përdorim për kontribute në të holla dhe kontribute në natyrë, me caktimin nga gjykata kompetente të një eksperti të autorizuar për këto kontribute me kërkesë të administratorit.

Në çdo rast, shumica nuk mund të detyrojë një ortak të rrisë pjesën e tij të kapitalit të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit aprovohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet, ulja e kapitalit është në përpjesëtim me pjesët takuese të kapitalit që përfaqësojnë Ortakët.



Vendimi për zvogëlimin e kapitalit, i komunikohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim, nga administratori, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej saj mund të blihen ose transferohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë,
- b) shitjes,
- c) trashëgimisë,
- d) dhurimit,
- e) çdo mënyre tjeter të parashikuar nga ligji.

Në rastin e kalimit të aksioneve me kontratë, kjo kontratë duhet të bëhet me shkrim.

Statuti mund ta kushtëzojë transferimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin ose të drejtën e parablerjes së shoqërisë në favor të shoqërisë ose ortakëve të tjerë.

Në rastin e transferimit të kuotave me kontratë, afatet dhe kushtet e transferimit të titullit të kuotës, si dhe kushtet e tjera kalimtare, duke përfshirë pagesën për blerjen e kuotave, rregullohen nga kontrata.

Kontrata për transferimin e kuotave hartohet me shkrim dhe noterizimi nuk është kusht për vlefshmërinë ose regjistrimin e kontratës. Me përashtim të rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj ose kur palët bien dakord për një kontratë, vlefshmëria, e së cilës, për kalimin e titullit të pronësisë mbi kuotat, nuk i nënshtronhet procedurave administrative të ndryshme me efekt deklarues, përfshirë këtu edhe procedurat e regjistrimit ose publikimit të kontratës ose transferimit të titullit.

KAPITULLI III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE MENAXHUESE

Neni 9

Organ i Vendimmarrjes

Asambleja e Ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës në Shoqëri.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton ndryshimet në statut sipas procedurave të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për vendimet e marra nga shoqëria për sa vijon:

- a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b. ndryshimet statutore;
- c. emërimi dhe heqja e Administratorëve;
- ç. Emërimi dhe heqja e likujdatorëve dhe e ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimi dhe shpërblimi i pësonave të cituar në gërmat "c" e "ç" të kësaj pike;
- dh. Mbikëqyrja mbi zbatimin e politikave tregtare nga ana e Administratorëve, duke përfshirë përgatitjen e bilanceve vjetore dhe raportet mbi progresin e biznesit;
- e. miratim të bilanceve vjetore dhe raporteve mbi progresin e biznesit;
- f. rritje dhe zvogëlim të kapitalit;
- g. ndarja e kuotave si dhe anullimi i tyre;
- h. përfaqësimi i shoqërisë në gjykim dhe procedime të tjera kundrejt Administratorëve;
- i. riorganizim dhe shpërbërje të shoqërisë;
- j. miratimi i rregullave procedurale për mbledhjet e Asamblesë;
- k. kërkojë kredi pranë çdo banke ose institucioni finansiar.



A2023051000062835763

1. Çështje të tjera të parashikuara në ligjore në Statut.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, nga një ortak tjetër ose nga një palë e tretë me anë të një autorizimi.

Drejtori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për pjesëmarrje në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet e ardhshme që do të kenë të njëjtin rend dite.

Neni 10

Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme

Mbledhja e përgjithshme thirret me komunikim me shkrim ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim me e-mail. Njoftimi me letër ose e-mail duhet të tregojë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe t'u dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpala datës së caktuar për mbledhjen.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk çështë thirrur në përputhje me pikën 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët pranojnë të marrin vendime pavarësisht nga parregullisja.

Neni 11

Kuorumi

Në rastin e vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të diskutojë në mënyrë të vlefshme vetëm nëse Ortakët me të drejtë vote zoterojnë më shumë se 30% të kuotave. Në rast se mbledhja vendos për çështje që kërkojnë shumicë të cilësuar sipas nenit 87 të ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë personalisht të pranishëm Ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të votave, duke votuar me anë të një letre ose me mjete elektronike, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendor në këtë nen, mbledhja do të thirret sërisht jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Proçesi i vendimmarrjes

Asambleja e Përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të Ortakëve pjesëmarrës ndryshimin e statutit, rrjeten ose pakësimin e kapitalit themeltar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shpërbërjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë votash të Ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si p.sh:

- a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b. ndryshimet statutore;
- c. emërimi dhe shkarkimin e Administratorëve;
- ç. Emërimi dhe shkarkimin e likujdatorëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimin e shpërbimit
- dh. Mbikëqyrja mbi zbatimin e politikave tregtare nga ana e Administratorëve, duke përfshirë përgatitjen e bilanceve vjetore dhe raportet mbi progresin e biznesit;
- e. përfaqësimi i shoqërisë në proçese gjyqësore dhe proçedime të tjera kundrejt Administratorëve;
- f. aprovimi i proçedurave rregullatore të mbledhjeve të Asamblesë

Çdo ndryshim ligjor duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për t'u pasqyruar në dosjen e shoqërisë.





A2023051000062835763

Neni 13

Përjashtim nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme vendos:

- a. shqyrtimin e veprimtarisë së tij
- b. shkarkimin nga çdo detyrim nën kujdestarinë e tij
- c. paraqesë një denoncim kundër tij nga Shoqëria
- ç. Nëse do t'i jepen ose jo përfitime të reja.

Kur Ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, për këtë të fundit duhet të përjashtohet paraprakisht konflikti i interesave me ato të ortakut që ai përfaqëson.

Neni 14

Administrimi

Z. Stefano Gentilim shtetas italian, i lindur në Dolo (VE) me 04/03/1988 banues ne adresë Via Roma, n. 80, Noventa Padovana, (PD) Itali me dokument identifikimi Leternjoftim CA21546KS, me kod fiskal CF. GNTSFN88C04D325W është Administrator sipas Statutit dhe Ligjit për një periudhë kohore prej pese (5) vitesh me të drejtë rinovimi duke filluar nga data 19.05.2023 - 19.05.2028.

Asambleja e përgjithshme mund t.i shkarkojë administratorët në çdo kohë kur arrihet shumica. Statuti ose marrëveshje të tjera nuk mund ta përjashtojnë ose kufizojnë këtë të drejtë.

Gjithashtu, Administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të njërit prej ortakëve.

Të drejtat e përfaqësimit të Administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre duhet të njoftohen për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person, jo ortak.

Neni 15 Kompetencat

Administratori autorizohet dhe ka detyrimin të:

- a) kryejë të gjitha operacionet e administrimit të aktivitetit tregtar, duke aplikuar politikat tregtare të caktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) ofrojë asistencë për mirëmbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
- ç) hartojë dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve dhe ia dorëzon këto dokumente Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) të krijojë një sistem paralajmërimi për rr Ethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e biznesit dhe ekzistencën e kompanisë.
- Dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme për shoqërinë, sipas ligjit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- e) raportojë së pari para Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe zbatimin e veprimeve specifike me rëndësi të veçantë për biznesin e shoqërisë tregtare.
- Ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara nga ligji dhe Statuti.





A2023051000062835763

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha vepritet e zakonshme të menaxhimit. Administratori përfaqëson shoqerinë përpara të gjithë personave fizikë dhe juridikë, autoritetet publike dhe/ose private, vendase ose të huaja, shqiptare ose të huaja, përfshirë autoritetet gjyqësore të të gjitha niveleve, bankat e të gjitha niveleve, etj. Administratori ka kompetencë të veprojë në marrëdhënie me të tretët për llogari të shoqërisë, si dhe para bankave të të gjitha niveleve, të kryejë transfera, tërheqje etj., pranë zyrave të tatimeve, zyrave të administratës vendore, punës, doganave. Autoritetet etj. Në të gjitha rrëthanat, me përjashtim të kompetencave që ligji u jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori e përfshin shoqerinë në marrëdhënie me të tretët nëpërmjet akteve në përputhje me objektin e tij të veprimitarës.

Neni 16

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori përgjigjet personalisht për shoqerinë ose për të tretët, për shkelje të ligjit, për shkelje të statutit ose për shkelje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme që dëmtojnë shoqerinë, i ngarkohen Administratorit ose ortakëve që kanë lidhur marrëveshjen për t'u marrë individualisht ose bashkërisht me pasojat e rastit në fjalë.

Me përjashtim të asaj që parashikohet nga dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, në zbatim të neneve 14, 15, 17, 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Administratori është i detyruar të:

a) kryejë funksionet e tij, të përcaktuara në legjislacion dhe statut, në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në përgjithësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës në kontekstin social.

b) ushtrojë kompetencat e njohura në ligj dhe statut vetëm për të arritur objektivat e përcaktuara në këto dispozita.

c) shqyrtojnë me përgjegjësi maksimale çështjet për të cilat marrin vendime.

Ç) parandalojnë dhe shmanget rastet e konfliktit aktual ose të mundshëm të interesave personale me ato të shoqërisë.

d) të ushtrojë funksionet e tij me profesionalizëm dhe përgjegjësi maksimale.

2) Administratori gjatë ushtrimit të detyrës i përgjigjet shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të pyetjeve dhe vlerësimit të informacionit përkatës, akti i veprimit ose mosveprimit është kryer në mirëbesim.

3) Në rast se Administratori vepron në kundërshtim me detyrat e tij dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, ai është i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet e shkaktuara nga shkelja dhe i kërkohet të kthejë fitimet që, ai dhe personat e lidhur, kanë gjeneruar, nga këto veprime të parregullta.

Administratori ka për detyrë të tregojë dëshmi për kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me standartet e kërkua. Kur shkelja kryhet nga më shumë se një Administrator, këta të fundit janë të detyruar t'i përgjigjen bashkërisht shoqërisë.

4) Në veçanti, por jo ekskluzivisht, Administratori është i detyruar t'i shlyejë shoqërisë çdo dëm të shkaktuar, në rast se bie ndesh me ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", duke kryer veprimet e mëposhtme:

A) shlyerjen e kontributeve për Ortakët;

B) pagesë të interesave ose të dividentit Ortakëve;

C) ndarjen e aktivit të shoqërisë

D) jep kredi



A2013051000062835763

Me përjashtim të kundërshtimeve personale ndaj administratorit, Ortakët, individualisht ose kolektivisht, ushtrojnë të drejtën për të bërë kallëzim penal kundër administratorit.

Kërquesit kanë të drejtë të kërkojnë pagesën e plotë të emit të shkaktuar ndaj shoqërisë, duke përfshirë kompensimin financier nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim I Asamblesë nuk mund të ndërpresë ngritjen e padisë ndaj Administratorit përlëshimet e kryera prej tij në ushtrimin e detyrës.

Neni 17

Viti Fiskal

Viti finanziar i kompanisë fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë finanziar i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon në datën 31 Dhjetor.

Neni 18

Bilanci i Shoqërisë dhe Dividendi

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit fiskal, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Asambleja e Ortakëve të shoqërisë vendos për shpërndarjen e dividentit, pas zbritjes së humbjeve të vitit fiskal të mëparshëm, siç e kërkon ligji.

Neni 19

Ekspertët

Ekspertët kanë detyrimin të kontrollojnë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë për të gjithë vitin dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të kryera prej tij në rastet kur ngarkohej nga Asambleja e Përgjithshme.

Për qëllime të kontrollit nga ana e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, përgatitet raporti me shkrim për nxjerrjen e rezultateve të bilanceve vjetore edhe për atë të kontolleve periodike të ushtruara, i cili duhet t'i paraqitet në kohë Asamblesë së Përgjithshme për t'u shqyrtuar dhe miratuar.

Neni 20

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të shpërndahet:

- a) kur përfundon kohëzgjatja për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurës së falimentimit në rast të burimeve të pamjaftueshme kapitale për të mbuluar kostot e parashikuara nga procedura e falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të pjesës kontraktore ose mospërbushjes së detyrave të organeve të shoqërisë ose për arsyet e tjera që e bëjnë të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;

5) në raste të tjera të parashikuara nga Statuti;

dh) ne raste te tjera të parashikuara nga Ligji;

e) për çdo rast tjeter e vendosur nga Asambleja e Ortakëve;

2. Shpërndarja e shoqërisë për një ose më shumë arsyet të parashikuara në shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e" të pikës 1 të këtij nenit, vendoset me shumicën e aksionarëve. Mbledhje, paragrafi i dytë 1 i nenit 87 të ligjit.

3. Në rast mosveprimi nga ana e Asamblesë së Ortakëve për të vendosur shpërbërjen, për arsyet e përcaktuara në shkronjat « a », « c », « d », « dh » të paragrafit 1 të këtij nenit, çdo person i interesuar mund të, në çdo kohë, të kërkojë në gjykatë për të vendosur shpërbërjen e shoqërisë.

4. Shpërndarja e shoqërisë, për rastet e parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij nenit, vendoset nga gjykata kompetente për procedurën e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë, janë likuiduar për shlyerjen e përbashkët të detyrimeve ndaj kreditorëve ose kur gjykata kompetente për procedurën e falimentimit refuzon kërkesën për





A202305100006283563

hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të mungesës së aktiveve të shoqërisë, për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

5. Shpërndarja e shoqërisë në rastet e parashikuara nga shkronja "ç", e pikës 1, të këtij nenit, vendoset nga gjykata kompetente, e parashikuar në nenin 3/1 të këtij ligji.

Neni 21

Likuidatori merr përsipër të drejtat dhe detyrat e Administratorëve që nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria cakton më shumë se një likuidator, përveç rasteve në të cilat akti i emërimit parashikon se ata veprojnë të pavarur nga njëri-tjetri, likuidatorët kryejnë bashkërisht të drejtat dhe detyrat sipas ligjit. Likuidatorët mund të autorizojnë njërin prej tyre për të kryer veprime të një kategorie të veçantë.

Likuidatori i nënshtrohet mbikëqyrjes së Ortakut dhe Administratorit/orëve.

Neni 22

Të drejtat dhe Detyrimet e Likuidatorëve

1. Detyra e likuidatorëve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, njohja e kredive/huave dhe kontributeve të papaguara, shitja e aktiveve të shoqërisë dhe pagesa e kreditorëve duke respektuar urdhrit e referencës, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuidatori mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, me qëllim mbylljen e një veprimi jo të plotë.
3. Nëse, në bazë të ankesave të kreditorëve, sipas nenit 194 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", likuidatorët vërejnë se pasuritë e shoqërisë tregtare, përfshirë edhe kontributet e papaguara, nuk janë të mjaftueshme për pagesën e këtyre kérkesave, likuidatorët janë të detyruar të pezullojnë procedurën e likujdimit dhe të kërkojnë nga gjykata fillimin e procedurës së falimentimit.
4. Likuidatori përgatit një bilanc në lidhje me gjendjen e shoqërisë në momentin e hapjes së likujdimit dhe një bilanc përfundimtar në momentin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likujdimit zgjat më shumë se një vit, likuidatori përgatit raportin finansiar vjetor të shoqërisë. Buxhetet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 23

Finalizimi i likujdimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbeturë, likuidatori njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit përfundimin e likujdimit dhe kërkon mbylljen e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 05.03.2007 "Për Qendrën Kombetare të Regjistrimit" e ndryshuar.

Neni 24

Shkrirja

Dy ose më shumë kompani mund të bashkohen përmes:

1. Transferimi i të gjitha aktiveve dhe detyrimeve të një ose më shumë shoqërive, të quajtura shoqëri të inkorporuara, te një shoqëri tjeter ekzistuese, e quajtur shoqëri blerëse, në këmbim të aksioneve ose kuotave të asaj shoqërie.
2. Krijimi i një shoqërie të re, së cilës i kalojnë të gjitha aktivet dhe detyrimet e shoqërive ekzistuese, të cilat bashkohen në këmbim të aksioneve ose kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet shkrirje me krijimin e një shoqërie të re.

Neni 25

Ndarja

1. Një shoqëri mund të shkrihet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, duke transferuar të gjitha aktivet dhe detyrimet e saj në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese ose të sapokrijuara. Shoqëria e ndarë konsiderohet e shpërbërë.



A2023051000062835763

2. Për shkrirjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 datë 14.04.2008.

3. Shoqëritë, të cilat thihin aktivet e shoqërisë që shkrijhet, quhen shoqëri pritëse dhe janë plotësisht përgjegjëse pér detyrimet e kësaj të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

- kalimin tek shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve dhe detyrimeve të shoqërisë që shkëputet, në përputhje me marrëdhëniet e shkëputjes, të përcaktuara në kontratën e shkëputjes. Ky transferim ka pasoja në marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, edhe pér të tretët;
- Vlerësimin e shoqërisë së shkëputur dhe mbyllja e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në zbatim të seksionit V të ligjit nr.9723, datë 05.03.2007 "Pér Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryer likujdimin.

Neni 26
Konvertimi

Shoqëria mund të ndryshojë formën e saj ligjore nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare. Konvertimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka marrë në përgjegjësi ndaj palëve të treta.

Neni 27
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për çdo gjë që nuk parashikohet në këtë statut zbatohen dispozitat e ligjit "Pér Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 28
Mosmarrëveshjet

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin me zbatimin dhe interpretimin e këtij statuti, si dhe pér çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet Shoqërisë dhe të tretëve, kompetente do të jetë Gjykata Shqiptare.

Neni 29
Dispozitat Përfundimtare

Ky Statut është hartuar në 4 kopje me të njëjtën vlerë ligjore, në shqip dhe italisht dhe është miratuar në tërësi nga aksionerët e shoqërisë tregtare "G&M ALBANIA" Shpk

ORTAKU THEMELUES

I SHOQËRISË "G&M ALBANIA" Shpk

STEFANO GENTILE
Stefano Gentile



Notarë
Dritan Speluly